

# INDEKSI I TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK

## PËR KABINETIN QEVERTAR

MARS 2016





# INDEKSI I TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK PËR KABINETIN QEVERITAR

MARS 2016





COPYRIGHT © 2016. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE .....</b>	<b>7</b>
<b>METODOLOGJIA.....</b>	<b>8</b>
<b>QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE .....</b>	<b>10</b>
<b>TRANSPARENCA BUXHETORE .....</b>	<b>13</b>
<b>TRANSPARENCA NË PROKURIM .....</b>	<b>15</b>
<b>TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE .....</b>	<b>18</b>
<b>KONKLUZIONE.....</b>	<b>20</b>

# HYRJJE

Transparenca mund të përkufizohet si qasje në informata në kohën e duhur, që është lehtësisht e kuptueshme, dhe mbron integritetin e procesit dhe interesat e të gjithë akterëve të përfshirë. Mirëpo, edhe pas shumë ndryshimeve ligjore dhe premtimeve institucionale, shpenzimet e fondeve publike përmes prokurimit publik në Kosovë në masë të madhe mbesin të mbyllura për publikun dhe si rezultat nuk janë të qasëshme nga shoqëria civile, media dhe vetë publiku. Sipas raporteve të publikuara prej autoriteteve qeveritare për vitin 2014<sup>1</sup>, nga gjithsej 1,589 Milion Euro<sup>2</sup> të Buxhetit të përgjithshëm qeveritar, 445.2 Milion Euro<sup>3</sup> janë shpenzuar përmes procedurave të prokurimit. Kjo vlerë paraqet 28% të vlerës së përgjithshme të buxhetit. Prokurimi publik paraqet një mundësi për të bërë një ndryshim apo për të ushtruar një ndikim në një nivel të caktuar, komunitet apo edhe rreth më të gjerë, dhe nuk ka të bëjë vetëm me blerjen e mallrave apo shërbimeve, por edhe me menaxhimin e këtyre kontratave, përputhshmëri ligjore, trajtim të drejtë, transparencë e llogaridhënie. Për çdo Euro që mund të kursehet gjatë procesit të prokurimit publik, janë një Euro më shumë që mund të shfrytëzohet për të përmirësuar kushtet aktuale të vendit, apo ndihmuar ata që kanë nevojë.

Sipas Cobus de Swardt, Drejtor Menaxher i Transparency International: “Kur produktet që, në fund të fundit, qytetarët paguajnë për të janë të rrezikshme, të papërshtatshme apo të kushtueshme do të jetë një humbje e pashmangshme e besimit të publikut në qeveri”. OECD vlerëson se korrupsioni në nivelet institucionale thith rreth 20-25 për qind të buxheteve qeveritare të prokurimit publik, dhe 57 për qind e rasteve të ryshfetit, të ndjekura nga

1 Per krahasim janë marr publikimet e vitit 2014, meqe publikimet për vitin 2015 janë edhe në përpunim nga Institucionet përkatëse

2 <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Buxheti/Buxheti-i-Republikes-se-Kosoves/Buxheti-qendrore>

3 <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/Raportet%20Vjetore/2014/Raporti%20vjetor%202014%20Shqip%20KRPP.pdf>

Konventa e OECD Kundër Mito-marrjes përfshijnë ryshfete të pranuar përmes kontratave publike.<sup>4</sup>

Informacioni duhet të jetë në dispozicion mënyrë pro aktive i ditur që nga vendimet më të hershme deri në auditimet e fundit. Vlerësimi i nevojave, buxhetet, njoftimet për kontrata, njoftimet për dhënie të kontratës, planifikimet e prokurimit, ankandet, etj., duhet të jenë të publikuara në mënyrë pro aktive, dhe në fazat sa më të hershme, që publiku të jetë i njoftuar dhe i përgatitur lidhur me atë se ku dhe si po shpenzohen taksat e tyre.

Shpenzimet e fondeve publike përmes prokurimit publik në Kosovë janë në masë të madhe të mbyllura për publikun dhe si rezultat nuk ka qasje dhe mbikëqyrje të duhur nga shoqëria civile, media dhe vetë publiku. Për këtë arsye Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) / Transparency International Kosova (TIK) është angazhuar që të përgatisë këtë Indeks të Transparencës në Prokurimin Publik.

Matja e transparencës në nivel qendror është një proces më ndërlikuar meqë ekzistojnë shumë burime të ndryshme, të dedikuara, për transparencë qeveritare, si ajo e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, Thesarit, dhe Ministri të ndryshme varësisht nga përgjegjësitë përkatëse. Synimi i këtij indeksi është që të bëjë presion tek institucionet që të ofrojnë transparencë më të lartë dhe qeverisje më të hapur brenda instancave të tyre, pa pasur nevojë që qytetari i thjeshtë të mbaj një hartë navigimi se ku do të mund t'i qasej dokumenteve të interesit. Qasja në informacion lidhur me shpenzimet publike përmes prokurimit publik do t'i mundësonte publikut të njihen më mirë se ku shkojnë taksat e tyre. Njëkohësisht transparenca më e madhe parandalon parregullsitë, keq-menaxhimin dhe korrupsionin në këto institucione.

4 <http://www.oecd.org/corruption/oecd-foreign-bribery-report-9789264226616-en.htm>

# METODOLOGJIA

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) degë e Transparency International (TI) për Kosovë ka zhvilluar një metodologji të matjes së transparencës në fushën e prokurimit publik për të gjitha institucionet lokale dhe qendrore. Metodologjia e tillë së pari është zbatuar në vitin 2014 kur është bërë edhe matja e parë transparencës së Kabinetit Qeveritar në shtylla të ndryshme. Ky Indeks i transparencës përfshinë të gjithat Institucionet e Kabinetit Qeveritar, duke përfshirë këtu Ministrinë dhe Zyrën e Kryeministrit. Indeksi bazohet në katër (4) shtylla kryesore dhe në 16 indikatorë të ndryshëm si vijon:

## NË SHTYLLËN E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE DO TË MATET:

- 1 Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike;
- 2 Numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike;
- 3 Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike, në fushën e prokurimit publik;
- 4 Numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumentet e prokurimit publik.

## NË SHTYLLËN E TRANSPARENCËS BUXHETORE:

- 5 Publikimi i buxhetit për vitin 2015 në ueb faqe;
- 6 Publikimi i planit të prokurimit për vitin 2015 në ueb faqe;
- 7 Raporti i auditimit në ueb faqe;
- 8 Raportet financiare në ueb faqe.

## NË SHTYLLËN E PROKURIMIT:

- 9 Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqe të institucionit (njoftimet për kontratë);
- 10 Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqe të KRPP;
- 11 Numri i fituesve të shpallur në ueb faqe (njoftimet për dhënie të kontratës);
- 12 Numri i fituesve të shpallur në ueb faqe të KRPP.







# QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Një nga katër shtyllat e matura në këtë indeks të transparencës është edhe qasja në dokumente publike. Qëllimi i matjes së këtij indikator nuk ka qenë vetëm të shihet se sa po respektohet Ligji për Qasje në Dokumente Publike, por edhe për të parë se sa qytetarët, organizatat e shoqërisë civile apo edhe mediat e shfrytëzojnë këtë mekanizëm për të kërkuar llogari nga institucionet qeveritare.

Fokus kryesor janë kërkesat për qasje në dokumente publike që lidhen me prokurimin publik. Sipas të dhënave që janë ofruar nga Kabineti Qeveritar pas kërkesës nga KDI, në të gjitha institucionet janë bërë 310 kërkesa për qasje në dokumente publike. Prej këtyre kërkesave, 81 kanë qenë të lidhura me prokurimin publik. Institucionet me numrin më të madh të kërkesave për qasje në dokumente publike, sipas të dhënave tona janë Ministria e Financave me 43 kërkesa, Zyra e Kryeministrit me 39 dhe Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës me 37 kërkesa.

Nga gjithsej 20 institucione të Kabinetit Qeveritar, tri (3) nga to nuk kanë kthyer përgjigje për të pasur qasje në dokumente publike. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Nga 20 Ministri të Qeverisë së Kosovës, duke përfshirë këtu edhe Zyrën e Kryeministrit (ZKM) që janë kontaktuar, 17 kanë kthyer përgjigje me informata mbi aktivitetet e tyre në zbatim të ligjit për qasje në dokumente publike.

Problemi kryesor me këto të dhëna për qasje në dokumente publike, mbetet fakti se të dhënat nuk mund të

verifikohen, e të krahasohen me të dhëna të pavarura, pasi burim të vetëm kanë institucionet qeveritare. Megjithatë ato janë një bazë e mirë për t'u analizuar.



Në krahasim me vitin e kaluar, ku sipas të dhënave ishin parashtruar 239 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare tek Kabineti Qeveritar, këtë vit ka pasur një rritje prej 71 kërkesave më shumë apo 29.7% më shumë, si dhe 17 kërkesa më shumë që lidhen me dokumente të prokurimit publik apo 26.5 %.

Institucionet Qeveritare (përpos atyre që nuk kanë kthyer përgjigje), janë përgjigjur brenda afatit ligjor siç përcaktohet në Nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-215 Për qasje në dokumente publike. Gjatë matjes së bërë në vitin e kaluar, gjysma e përgjigjeve ishin ofruar jashtë afatit ligjor.





## NUMRI I KËRKESAVE PËR QASJE TË DËRGUARA NGA KDI TEK INSTITUCIONET E KABINETIT QEVERITAR DHE PËRGJIGJET NË KËRKESA



### LISTA E MINISTRIVE QË NUK KANË KTHYER PËRGJIGJE

**1** MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

**2** MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

**3** MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM



## TË DHËNAT NGA KABINETI QEVERITAR PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

### QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

	Nr. Total i kërkesave për vitin 2015	Nr. total i kërkesave të refuzuara për 2015	Nr. i kërkesave të lidhura me prokurim publik 2015	Nr. i kërkesave të refuzuara për Prokurim Publik
1 Zyra e Kryeministrit të Kosovës	39	21	17	11
2 Ministria e Administratës Publike	21	0	0	0
3 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	6	0	1	0
4 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	4	0	0	0
5 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	13	1	0	0
6 Ministria e Diasporës	11	0	0	0
7 Ministria e Drejtësisë	7	0	0	0
8 Ministria e Financave	43	0	0	0
9 Ministria e Zhvillimit Ekonomik	17	0	2	2
10 Ministria e Integrimit Evropian	10	1	0	0
11 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	30	1	5	0
12 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor		nuk kanë kthyer përgjigje		
13 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	19	5	0	0
14 Ministria e Punëve të Brendshme	9	1	5	0
15 Ministria e Punëve të Jashtme		nuk kanë kthyer përgjigje		
16 Ministria e Shëndetësisë	28	0	18	0
17 Ministria e Infrastrukturës	8	0	3	0
18 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	8	0	0	0
19 Ministria për Komunitete dhe Kthim		nuk kanë kthyer përgjigje		
20 Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	37	0	30	0
<b>Total</b>	<b>310</b>	<b>30</b>	<b>81</b>	<b>13</b>



të këtyre prokurimeve, si dhe parashikimet e vlerës së prokurimeve. Përveç që ky planifikim ofron mundësinë e konsolidimit të prokurimit të artikujve të ngjashëm apo interesit të përbashkët, ai jep një mundësi ndërmarrësve që të bëjnë planifikimet dhe përgatitjet e nevojshme për qasje në prokurim publik, si dhe që ofertat e tyre të jenë sa më konkurruese. Sipas legjislacionit paraprak, i cili ishte në fuqi gjatë periudhës së vlerësimit, Publikimi i Planifikimit të Prokurimit ishte i ndaluar nën pretekstin se publikimi i vlerave të parapara të prokurimeve do të humbiste vlerën e tregut, dhe Operatorët Ekonomik do të ofertonin çmime sa më të përafërta me vlerat e parashikuara buxhetore.

Ashtu si vitin e kaluar, nga 20 institucionet e vlerësuara, asnjë nga to nuk e ka të publikuar planin e prokurimit në formë të njoftimit paraprak, apo me çmime të larguara.

## RAPORTI I AUDITORIT NË UEB FAQE

Publikimi i raportit të auditimit për vitin 2015 është një tjetër indikator me rëndësi, pasi në këtë formë i ofron publikut të dhëna se si janë menaxhuar paratë publike nën menaxhimin Institucioneve Qeveritare. Këtë vit sipas të dhënave që KDI ka nxjerrur, asnjë institucion qeveritar nuk ka publikuar raportin e auditorit në uebfaqe zyrtare. E njëjta shifër ka qenë e evidentuar dhe në raportin e vitit 2015, kështu që nuk ka pasur asnjë vetëdijesim dhe përmirësim në publikimin e këtyre raporteve. Duhet të ceket se raportet e auditimit për të gjitha institucionet qeveritare gjenden në faqen e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. Megjithatë, ato duhet të ju ofrojnë qytetarëve mekanizma shtesë të informimit rreth raporteve të tilla që kanë synim institucionet qeveritare. Mungesa e pasqyrit të raporteve të tilla në ueb faqet e Institucioneve Qeveritare të Kosovës paraqet vështirësi për qytetarët në gjetjen e tyre duke u pa mundësuar qytetarëve qasje në informata të mjaftueshme mbi raportet e auditorit të përgjithshëm dhe mbi të gjitha mbi mënyrën e realizimit dhe shpenzimit të parasë publike nga Ministrinë përkatëse. Nëse këto in-

stitucione nuk publikojnë raportin e tyre të në ueb faqen zyrtare, të paktën mund të ofrojnë një lidhëz se ku mund të gjendet raporti i tillë.

## NUMRI I RAPORTEVE TË SHPENZIMEVE FINANCIARE JANAR- DHJETOR 2015

Ashtu si vitin e kaluar, nga 19 Ministri dhe ZKM, kemi gjetur se përsëri vetëm pesë (5) prej tyre kanë publikuar raportet e shpenzimeve financiare për vitin 2015. Pjesa tjetër e institucioneve nuk kanë publikuar raporte financiare për vitin 2015.

INSTITUCIONET QEVERITARE TË KOSOVËS		NR. I RAPORTEVE TË SHPENZIMEVE FINANCIARE JANAR- DHJETOR 2015
1	Zyra e Kryeministrit të Kosovës	0
2	Ministria e Administratës Publike	1
3	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1
4	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	0
5	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	0
6	Ministria e Diasporës	1
7	Ministria e Drejtësisë	52
8	Ministria e Financave	3
9	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	0
10	Ministria e Integritimit Evropian	0
11	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	0
12	M. e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	0
13	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	0
14	Ministria e Punëve të Brendshme	0
15	Ministria e Punëve të Jashtme	0
16	Ministria e Shëndetësisë	0
17	Ministria e Infrastrukturës	0
18	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	0
19	Ministria për Komunitete dhe Kthim	0
20	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	0
<b>Total</b>		<b>58</b>

# TRANSPARENCA NË PROKURIM

## TRANSPARENCA NË TENDERIM

Në këtë shtyllë është matur transparenca e Institucioneve Qeveritare në prokurim publik. Katër indikatorë janë krahasuar për të parë dallimin e njoftimeve në mes të ueb faqeve të institucioneve dhe njoftimeve që këto institucione kanë publikuar në ueb faqen e KRPP-së. Duke pas parasysh se ueb faqja e KRPP-së i shërben në masë të madhe bizneseve dhe në përgjithësi operatorëve ekonomik, ne kemi dashur të shohim se sa këto institucione i publikojnë njoftimet për tender në ueb faqet e tyre, me qëllim të informimit sa më të mirë të qytetarëve. Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, i cili ishte në fuqi gjatë periudhës së vlerësimit, si dhe sipas legjislacionit sekondar (A01 Rregullore për Prokurim Publik dhe A02 Udhëzues Operativ për Prokurimin Publik) të gjitha njoftimet për kontratë mbi vlerën 10,000€, si dhe të gjitha njoftimet për dhënie të kontratës mbi vlerën 1,000€ duhet të publikohen në ueb faqen e KRPP. Megjithatë, publikimi i të gjitha njoftimeve në ueb faqet e tyre, pa marr parasysh vlerat, tregon një praktikë të mirë e Institucioneve për të treguar sinqeritet dhe vullnet të mirë ndaj qytetarëve të vet.

Katër indikatorët që janë krahasuar për të parë dallimin e njoftimeve në mes të ueb faqeve të Institucioneve Qeveritare përkatëse dhe njoftimeve që këto institucione kanë publikuar në ueb faqen e KRPP-së janë:

- 1 Numri i njoftimeve për kontratë të publikuar në ueb faqen e Kabinetit Qeveritar janar-dhjetor 2015
- 2 Numri i njoftimeve për kontratë të publikuar në ueb faqen e KRPP
- 3 Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës të publikuar në ueb faqen e Kabinetit Qeveritar janar-dhjetor 2015
- 4 Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës të publikuar në ueb faqen e KRPP janar - dhjetor 2015

## NJOFTIMET PËR KONTRATË

Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqet e Institucioneve Qeveritare zakonisht dallon shumë për nga numri i tenderëve në ueb faqen e KRPP-së. Ky dallim vie për shkak se mos publikimi i tenderëve sipas vlerave të paracaktuara ligjore në ueb faqen e KRPP-së është në kundërshtim me ligjin dhe Autoritetet Kontraktuese mund të penalizohen për këto veprime. Megjithëse edhe njoftimet e publikuara në ueb faqen e KRPP-së nuk janë të plota dhe shpesh kanë mangësi, sidomos meqë ato janë në vullnetin e Kabinetit Qeveritar, dhe të vetmin mjet krahasues KRPP ka raportin vjetor të prokurimeve, ku mund të bëhet krahasimi ndërmjet raportit dhe njoftimeve paraprake për periudhën në vlerësim. Në përgjithësi, institucionet qeveritare i kanë të publikuara njoftimet në uebfaqet e tyre, me

përrjashtim të disave, të cilat të cilat i publikojnë vetëm disa, dhe jo të gjitha llojet.

Publikimi i njoftimeve në ueb faqe të institucioneve është i rëndësishëm për bizneset lokale dhe qytetarët të cilët mbase do të kishin një ide më të saktë se në çka janë duke investuar institucionet e qeverisë së tyre, me çfarë çmimi dhe me cilët operatorë ekonomik.



Nga 547 njoftime të tenderëve të publikuar në ueb faqen e KRPP-së, vetëm 75 prej tyre janë publikuar edhe në ueb faqet e Kabinetit Qeveritar apo në përqindje vetëm 28% e tenderëve janë publikuar edhe në ueb faqet e institucioneve përkatëse.

Duke i krahasuar këto vlera me Indeksën e Transparencës në Prokurim Publik për Kabinetin Qeveritar, për vitin 2014, shohim se kemi një përmirësim të vogël të transparencës ku nga 11% të tenderëve të publikuar për vitin 2014, kemi një rritje prej vetëm 16%, respektivisht në 28% për vitin 2015.

Ndërsa numri i njoftimeve të tenderëve të publikuar në KRPP vitin e kaluar ka qenë 653, që i bie se në vitin 2015 janë publikuar 106 njoftime të tenderëve më pak. Një nga arsytet e numrit më të vogël të publikimit të tenderëve mund të jetë edhe ai i fillimit të aplikimit të prokurimit të centralizuar nga AQP.

Duke u bazuar në tabelën e më poshtme, Ministrinë më transparente në këta dy indikatorë janë si në tabelën më poshtë:

#	INSTITUCIONET QEVERTARE	NR.I TENDERËVE TË PUBLIKUAR NË UEB FAQEN E INSTITUCIONEVE QEVERTARE JANAR-DHJETOR 2015	NR. I TENDERËVE TË PUBLIKUAR NË UEB FAQEN E KRPP PËR 2015	%
1	Ministria e Financave	41	41	100%
2	Ministria e Administratës Publike	15	21	71%
3	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	40	83	48%
4	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	14	34	41%
5	Ministria e Drejtësisë	2	5	40%
6	Ministria e Integritit Evropian	4	19	21%
7	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	71	71	87%



## NJOFTIMET PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Për sa i përket njoftimeve për dhënie të kontratës, nga 659 njoftime të tenderëve të publikuar në ueb faqen e KRPP-së, vetëm 169 prej tyre janë publikuar edhe në ueb faqet e institucioneve apo në përqindje vetëm 21% e fituesve të kontratave janë publikuar edhe në ueb faqet e institucioneve përkatëse.

Duke i krahasuar këto vlera me Indeksin e Transparencës në Prokurim Publik për Institucionet Qeveritare për vitin 2015, shohim se kemi një përmirësim të nivelin e transparencës ku nga 63 njoftime për vitin 2014, kemi një rritje prej 102 njoftime, respektivisht një rritje të transparencës prej 13% për vitin 2015, konform numrit të përgjithshëm të publikimeve.



Gjatë krahasimit të publikimeve të njoftimeve për kontratë, rezultojnë se gjashtë institucionet qeveritare më transparente në publikimin e njoftimeve për dhënie të kontratës janë:

#	INSTITUCIONET QEVERTARE TË KOSOVËS	NR. I FITUESVE TË TENDERËVE NË UEB FAQEN E INSTITUCIONEVE QEVERTARE TË KOSOVËS JANAR-DHJETOR 2015	NR. I FITUESVE TË TENDERËVE NË UEB FAQEN E KRPP JANAR - DHJETOR 2015	%
1	Ministria e Financave	28	28	100%
2	Ministria e Administratës Publike	69	69	100%
3	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	49	56	88%
4	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	12	21	57%
5	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	10	20	50%
6	Ministria e Drejtësisë	1	16	6%



# TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE


## NJOFTIM PËR SHITJE TË ASETEVE

Në krahasim me numrin e prokurimeve publike, numri i ankandeve është shumë më i vogël dhe artikujt të cilët shiten përmes ankandeve nuk kanë vlera të mëdha, prapë se prapë ne kemi dashur të matim publikimin e njoftimeve për këto ankande.

Katër indikatorët që janë krahasuar për të parë dallimin e njoftimeve në mes të ueb faqeve të institucioneve qeveritare përkatëse dhe njoftimeve që këto institucione kanë publikuar në ueb faqen e KRPP-së janë:

- 1 Numri i njoftimeve për shitje të aseteve të publikuar në ueb faqen e Institucioneve Qeveritare janar-dhjetor 2015
- 2 Numri i njoftimeve për shitje të aseteve të publikuar në ueb faqen e KRPP
- 3 Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës të publikuar në ueb faqen e institucioneve qeveritare janar-dhjetor 2015
- 4 Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës të publikuar në ueb faqen e KRPP janar - dhjetor 2015

Nga të dhënat e mbledhura nga ueb faqet e Institucioneve Qeveritare dhe atë të KRPP-së, shohim se numri i publikimeve të njoftimeve për Ankande si dhe njoftimeve për dhënie të kontratës nuk është i madh. Ajo që është shqetësuese është se transparenca qeveritare në këta indikator është tejet e vogël. Meqë publikimi i Ankandeve në ueb faqe të KRPP-së është një detyrim ligjor, për vitin 2015, kemi pesë (5) njoftime për Ankande në ueb faqe të KRPP-së, dhe vetëm katër (4) prej tyre janë të publikuara në ueb faqet e Institucioneve Qeveritare.



Dy Ministrinë e vetme që kanë treguar transparencë në procesin e publikimit të njoftimeve të ankandeve janë si në vijim:






#	INSTITUCIONET QEVERITARE TË KOSOVËS	NR. I FITUESVE TË TENDERËVE NË UEB FAQEN E INSTITUCIONEVE QEVERITARE TË KOSOVËS JANAR-DHJETOR 2015	NR. I FITUESVE TË TENDERËVE NË UEB FAQEN E KRPP JANAR - DHJETOR 2015
1	Ministria e Financave	3	0
2	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1	0

## NJOFTIM PËR DHËNIE KONTRATE

Pothuajse të njëjtën situatë kemi edhe me publikimet për dhënie të kontratës përmes Ankandëve publike, ku niveli i transparencës qeveritare është 0% në krahasim me publikimet në ueb faqe të KRPP-së.



# KONKLUZIONE

## TË PËRGJITHSHME

Nuk vërehet një trend pozitiv i rritjes së transparencës së dokumenteve të publikuara nga Kabineti Qeveritar që kanë të bëjnë më prokurimin publik.

Mungon një pasqyrë e qartë e planifikimit, konsultimit me qytetarë dhe publikimit të shpenzimeve të Kabinetit Qeveritar në Kosovë.

Uebfaqet e Kabinetit Qeveritar nuk kanë konsistencë dhe qartësi në prezantimin e informacioneve dhe dokumenteve që lidhen me shpenzimet e tatimeve dhe taksave të qytetarëve.

Të dhënat e gatshme që përgatiten nga institucionet qeveritare sikurse njoftimet për kontratë dhe njoftimet për dhënie kontrate, lehtësisht mund të publikohen në uebfaqet e tyre. Gjithashtu, raportet e Auditorit të Përgjithshëm dhe buxheti i publikuar nga thesari janë gjithashtu të dhëna që janë të gatshme për publikim në uebfaqe të ministrive dhe ZKM. Ato të dhëna shumë lehtë mund të përdoren për të pasuruar uebfaqet e vetë këtyre institucioneve pa shpenzuar kohë dhe resurse tjera.

## QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Ndonëse tri (3) nga 20 institucione të Kabinetit Qeveritar nuk kanë kthyer fare përgjigje, përgjithësisht niveli i përgjegjshmërisë së institucioneve karshi kërkesave të KDI-së është i kënaqshëm..

Nga 17 përgjigjet që KDI ka inkasuar nga kabineti qeveritar tregojnë se krahasuar me 2014, ka rritje të

numrit të kërkesave të parashtruara në institucionet e Kabinetit Qeveritar për 29.7%. Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar për vitin 2014 ishte 239, kjo shifër është ngritur në 310 në vitin 2015.

Në vitin 2014, në 19 Ministri dhe ZKM u parashtruan 64 kërkesa për qasje në dokumente publike në prokurim publik. Ky numër në vitin 2015 është ngritur në 81, që shënon gjithashtu një rritje të kërkesave për 26.5%

Këta dy indikatorë tregojnë që interesimi i publikut, gazetarëve apo bizneseve për informacion nga Kabineti Qeveritar mbi procesin e prokurimit publik është në rritje.

## TRANSPARENCA BUXHETORE

Kabineti Qeveritar, krahasuar me vitin e kaluar, nuk ka treguar përmirësim të transparencës buxhetore, sa i përket publikimit të dokumenteve lidhur me buxhetin, planin e prokurimit, raportin e auditorit dhe raporte të shpenzimeve.

Në këtë shtyllë, Institucionet Qeveritare më transparente janë: Ministria e Drejtësisë, pasuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

## TRANSPARENCA NË PROKURIM

Një numër i madh i institucioneve të Kabinetit Qeveritar nuk publikojnë në uebfaqet e tyre njoftimet për kontratë apo njoftimet për dhënie të kontratës. Përmes këtyre dy dokumenteve qytetarët, mediat apo edhe të interesuarit e tjerë mund të shohin se kur një institucion



ka shpallur një tender dhe kush janë fituesit e tyre. Edhe pse ligjërisht kërkohet që njoftimet të publikohen në faqen e KRPP-së, shumë qytetarë e kanë më të lehtë të orientohen në institucionet përkatëse, sipas kërkesave specifike.

Duke bërë një krahasim me nivelin e transparencës për vitin 2014, për sa i përket shtyllës së transparencës në tenderim, është evidentuar një mesatare prej 24.8%. Mesatarja ende mbetet larg nga një transparencë e plotë që do të duhej të ishte synim i çdo udhëheqjeje llogaridhënëse. Ministritë më transparente sa i përket transparencës në prokurim janë treguar: Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Integritimit Evropian.

## TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE

Përmes ankandeve institucionet e Kabinetit Qeveritar shesin zakonisht mallra të konfiskuara apo edhe pajisje të cilat nuk janë të përdorshme nga institucioni. Sidoqoftë kjo kategori përgjithësisht vazhdon të mbetet jo-transparente për sa i përket publikimeve, dhe vullnetit të mirë që Kabineti Qeveritar të njoftojnë qytetarët e tyre për këto veprime. Ministritë më transparente në këtë shtyllë janë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave.



# SHTOJCA 1.

## LISTA E PYETJEVE QË U JANË DËRGUAR KABINETIT QEVERITAR

**PYETJA 1:** Sa është numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike në Ministrinë tuaj gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015?

**PYETJA 2:** Sa është numri i përgjithshëm i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike në Ministrinë tuaj gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015?

**PYETJA 3:** Sa është numri i kërkesave për qasje në dokumente publike në Ministrinë tuaj në fushën e prokurimit publik gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015?

**PYETJA 4:** Sa është numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike në Ministrinë tuaj në fushën e prokurimit publik gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2014?

**PYETJA 5:** Sa është numri i dëgjimeve publike të organizuara nga Ministria e juaj në vitin 2015, gjatë procesit të hartimit të Buxhetit për vitin 2015?

**PYETJA 6:** A publikoni në ueb faqen e juaj të dhëna të tilla si: raport të auditorit, raport të shpenzimeve, njoftim për kontratë dhe njoftim për dhënie të kontratës?

Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

342 (496.51)“2016”  
347.75 (496.51)“2016”

Indeksi i transparencës në prokurimin publik për kabinetin  
qeveritar : mars 2016 / Instituti Demokratik i Kosovës. –  
Prishtinë : Instituti Demokratik i Kosovës, 2016. – 24 f. :  
ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

**ISBN 978-9951-8927-3-5**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen financiare të:



British Embassy  
Pristina

